



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 shkurt 2021
Nr. ref.:RK1699/21

AKTVENDIM PËR PAPRANÛESHMËRI

në

rastin nr. KI40/20

Parashtrues

Sadik Gashi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit, Ac. nr. 1449/2011,
të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 30 janarit 2012 dhe Aktgjykimit,
Rev. nr. 333/2019 të Gjykatës Supreme, të 6 nëntorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Sadik Gashi, me vendbanim në Komunën e Prishtinës, i cili përfaqësohet nga Basri Morina, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston (i) Aktvendimin [Ac.nr.1449/2011] e 30 janarit 2012 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Qarkut) në lidhje me Aktvendimin [C. nr. 559/09] e 15 shtatorit 2011 të Gjykatës Komunale në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale); dhe (ii) Aktgjykimin [Rev. nr. 333/2019] e 6 nëntorit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 3710/2015] e 11 qershorit 2019 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C. nr. 559/2009] e 16 dhjetorit 2014 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuarra përmes të cilave, sipas pretendimit, parashtruesit të kërkesës i janë shkëlur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

5. Më 25 shkurt 2020, Gjykata pranoi kërkesën e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës.
6. Më 28 shkurt 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.
7. Më 5 mars 2020, Gjykata (i) njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës; dhe (ii) i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 20 janar 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 22 gusht 2008, në Shërbimin e Ofiqarisë në Komunën e Kamenicës, parashtruesi i kërkesës dhe B.F., kishin lidhur martesë. Ndërsa, më 19 shkurt 2009, kishte lindur edhe fëmija i përbashkët i tyre.
10. Në një datë të paspecifikuar, B.F. kishte paraqitur padi për shkurorëzim në Gjykatën e Qarkut.
11. Më 18 mars 2009, B.F., gjithashtu i ishte drejtuar Gjykatës Komunale me (i) kërkesëpadi “*për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve*”; dhe (ii) kërkesë për caktimin e masës së sigurisë, në mënyrë që t’i ndalohet parashtruesit të kërkesës “*tjetërsimi apo ngarkimi me peng ose hipotekë*” i paluajtshmërisë të regjistruar në zonën kadastrale në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: paluajtshmëria kontestuese).

Procedura përkitazi me padinë për shkurorëzim

12. Më 16 nëntor 2009, Gjykata e Qarkut përmes Aktgjykimit [C.nr.132/2009] vendosi që: (i) të zgjidhë “*kurorën*” e lidhur më 22 gusht 2008 në mes të parashtruesit të kërkesës dhe B.F.-së; (ii) fëmija i përbashkët t’i besohet parashtruesit të kërkesës në “*ruajtje, edukim dhe kujdes të mëtejshëm*”; dhe (iii) të detyrojë B.F.-në, që në emër të “*ushqimisë*” të paguajë çdo muaj shumën prej 50 eurosh.
13. Më 11 shkurt 2010, kundër Aktgjykimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme, duke propozuar që të konstatohet se martesë është zgjidhur me fajin e B.F.-së, dhe për pasojë kjo e fundit të detyrohet që në emër të ushqimisë për fëmijën të paguajë shumën në vlerë prej 100 euro në muaj, duke filluar nga 1 dhjetori 2010 e tutje.
14. Më 13 gusht 2010, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Ac.nr.16/2010], ankesën e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin [C.nr 132/2009] e 16 nëntorit 2009 të Gjykatës së Qarkut.

Procedura përkitazi me kërkesën për masën e sigurimit

15. Më 1 prill 2009, Gjykata Komunale përmes Aktvendimit [C.nr.559/09] miratoi kërkesën e B.F.-së dhe caktoi masën e sigurimit, përmes së cilës parashtruesit të kërkesës i ndaloi “*tjetërsimin apo ngarkimin me barrë, hipotekë, peng si dhe vërtetim dhe legalizim i çfarëdo kontrate të shitblerjes së paluajtshmërisë që është objekt kontesti*”.
16. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktvendimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Qarkut, me propozim që Aktvendimi i kontestuar të anulohet dhe çështja t’i kthehet në rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

17. Më 23 korrik 2010, Gjykata e Qarkut përmes Aktvendimit [Ac. nr. 670/2010] anuloi Aktvendimin [C. nr. 5559/09] e 1 prillit 2009 të Gjykatës Komunale dhe çështjen e ktheu në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
18. Më 15 shtator 2011, Gjykata Komunale përmes Aktvendimit [C.nr.559/09], sërish caktoi masën e sigurimit përkitazi me palujatshmërinë kontestuese.
19. Më 19 shtator 2011, kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Komunale, parashtruesi i kërkesës sërish parashtrroi ankesë në Gjykatën e Qarkut, me propozim që Aktvendimi i kontestuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
20. Më 30 janar 2012, Gjykata e Qarkut përmes Aktvendimit [Ac.nr.1449/2011] ankesën e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin [C.nr.559/09] e 15 shtatorit 2011 të Gjykatës Komunale, duke lënë në fuqi masën e sigurimit.

Procedura përkitazi me kërkesëpadinë për “kompensim të pasurisë së veçantë”

21. Më 3 dhjetor 2013, B.F. gjatë seancës së mbajtur në Gjykatën Themelore kishte precizuar kërkesëpadinë e saj, duke parashtruar kërkesë për “kompensim të pasurisë së veçantë” në bazë të nenit 46 (Pasuria e veçantë e bashkëshortëve) të Ligjit nr. 2004/32 për Familjen (në tekstin e mëtejme: Ligji për Familjen) në vend të kërkesës fillestare për “pjesëtim të pasurisë së përbashkët të krijuar në martesë”. B.F. kishte kërkuar kompensimin e vlerës së shtëpisë, në shumë prej 44,047.00 euro, e cila sipas kërkesëpadisë “ishte ndërtuar me mjetet financiare të dhuruara nga babai i saj para lidhjes së martesës”.
22. Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata Themelore, kishte vlerësuar dy ekspertiza për llogaritjen e vlerës së punimeve për ndërtimin e shtëpisë, të përgatitura nga (i) eksperti Q.F., i cili kishte përcaktuar vlerën në shumë prej 39.708.00 euro; dhe (ii) eksperti S.C., i cili kishte përcaktuar vlerën në shumë prej 31,382.72 euro.
23. Më 16 dhjetor 2014, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.559/2009], (i) konstatoi se shtëpia e ndërtuar nga babai i B.F.-së paraqet “pasuri të veçantë të fituar përmes dhurimit, gjatë kohëzgjatjes së fejesës dhe jetës së përbashkët para lidhjes së martesës.”; (ii) pjesërisht miratoi kërkesëpadinë e B.F.-së dhe detyroi parashtruesin e kërkesës që në emër të kompensimit të pasurisë së veçantë, B.F.-së t’i paguajë shumën prej 31,582 euro, me kamatë ligjore “që paguajnë bankat afariste për mjetet e afatizuara mbi një vit, pa destinim të caktuar duke filluar nga 16 dhjetori 2014 deri në pagesën përfundimtare”; dhe (iii) refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të padisë së B.F.-së, që ndërli dhej me “specifikacionin e punëve të kryera, blerjes së materialit ndërtimor apo për blerjen e orendive të shtëpisë dhe borxhit personal në shumë të përgjithshme prej 12,465.00 euro”. Gjithashtu, bazuar në arsyetimin e Gjykatës Themelore, rezulton se (i) e njëjta kishte bazuar vendimin e saj në ekspertizën e ekspertit S.C.; (ii) parashtruesi i kërkesës këtë ekspertizë e kishte vlerësuar si “më të afërt me realitetin ekzistues” dhe se i njëjti nuk kishte propozuar superekspertizë,

“për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike”; dhe (iii) gjatë shqyrtimit gjyqësor ishin dëgjuar edhe dëshmitarët E.F., S.K.H., E.K., N.H., F.Rr. dhe M.S.

24. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që ankesa e tij të aprovohet si e bazuar, të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në pikën I të dispozitivit dhe rrjedhimisht, të refuzohet padia dhe kërkesëpadia e B.F.-së si e pabazuar ose çështja të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë. Parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij, ndër tjerash, kishte theksuar se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Themelore (i) është nxjerrë në shkelje të pikës n) të paragrafit 2 të nenit 182 [pa titull] të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK) sepse *“dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendi të tij dhe me arsytet e aktgjykimit.”*; (ii) paragrafit 2 të nenit 257 (Ndryshimi i padisë) të LPK-së sepse gjykata kishte lejuar ndryshimin e kërkesëpadisë së B.F.-së; (iii) kishte dështuar të vërtetojë mungesën e legjitimitetit aktiv të B.F.-së, sepse *“ajo nuk ishte në raport juridik me të, por ishte babai i saj, i cili nuk është palë në këtë procedurë.”*; (iv) gabimisht kishte vlerësuar se bëhet fjalë për pasuri të veçantë sepse *“bashkëshorti e fiton vetëm gjatë martesës e jo para lidhjes së martesës.”*; dhe (v) nuk ka vërtetuar në mënyrë të saktë *“lartësinë e kërkesëpadisë”* sepse në procedurë para Gjykatës Themelore ishin dy ekspertë, me raporte kontradiktore dhe *“diferenca e lartë”* në mes tyre reflekton se *“asnjëra nga këto dy ekspertiza nuk ishin të sakta”*.
25. Më 11 qershor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 3710/2015] e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 559/2009] e 16 dhjetorit 2014 të Gjykatës Themelore.
26. Më 20 gusht 2019, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale me propozimin që të aprovohet kërkesa e tij për revizion si e bazuar, të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe ai i Apelit, duke e refuzuar padinë dhe kërkesëpadinë e B.F.-së si të pabazuar ose çështjen ta kthejë në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
27. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për revizion theksoi, ndër tjerash, se Aktgjykimet e gjykatave më të ulëta ishin nxjerrë në (i) shkelje të paragrafit 1 dhe pikës n) të paragrafit 2 të nenit 182 të LPK-së; (ii) shkelje të dispozitave të LPK-së sepse gjyqtari që kishte vendosur në lidhje me rastin në Gjykatën Themelore ishte i anshëm dhe se në procesverbalin e 20 shkurtit 2014, nuk është reflektuar kërkesa e tij për përjashtimin e gjyqtarit; (iii) shkelje të dispozitave të LPK-së, sepse gjykata përkatëse ka qenë e detyruar që sipas detyrës zyrtare të caktojë superekspertizën si rezultat i mos përputhjes në mes të dy ekspertizave të dorëzuara në Gjykatë Themelore; dhe (iv) paragrafit 2 të nenit 257 të LPK-së sepse gjykata kishte lejuar ndryshimin e kërkesëpadisë së B.F.-së, duke theksuar gjithashtu që *“pasuria ishte e përbashkët me ish-bashkëshorten e tij për arsye se sipas tij babai i saj ndërtimin e shtëpisë e kishte financuar për të dytë dhe*

shtëpia ishte ndërtuar në truallin, e cila ishte pronë e parashtruesit të kërkesës”.

28. Më 6 nëntor 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 333/2019] revizionin e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar. Përmes këtij Aktgjykimi, Gjykata Supreme, ndër tjerash, theksoi se (i) bazuar në paragrafin 2 të nenit 214 [pa titull] të LPK-së, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, dhe rrjedhimisht ajo nuk do t'i shqyrtojë ato pretendime; (ii) bazuar në nenin 46 të Ligjit për Familjen, gjykatat më të ulëta, kishin vendosur drejtë përkitazi me *“pasurinë e veçantë”* të B.F.-së, sepse *“dhurata paraqet titull juridik për fitimin e pronësisë së veçantë, pa marrë parasysh se dhurata ka pas për qëllim përdorimin e përbashkët të bashkëshortëve.”*; (iii) pretendimet përkatëse përkitazi me shkeljet e paragrafit 1 dhe pikës n) të paragrafit 2 të nenit 182 të LPK-së në lidhje me paragrafin 5 të nenin 160 [pa titull] të LPK-së janë të pabazuara, duke sqaruar se parashtruesi i kërkesës e kishte kundërshtuar ekspertizën e ekspertit Q.F., dhe për pasojë, Gjykata Themelore kishte caktuar ekspertin S.C., në të cilën seancë të shqyrtimit, parashtruesi i kërkesës nuk kishte kërkuar ekspertizë tjetër apo superekspertizë; dhe (iv) pretendimet përkatëse përkitazi me mos reflektimin e kërkesës së parashtruesit të kërkesës *“për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes”* janë gjithashtu të pabazuara sepse *“i autorizuari i tij e kishte nënshkruar procesverbalin pa vërejtje”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
30. Përkitazi me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se (i) Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk përmbush standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, posaçërisht në lidhje me dy ekspertizat *“diametralisht të kundërta”*, bazuar në të cilat Gjykata Themelore ka përcaktuar vlerën përkatëse të kompensimit, ndërsa nuk kishte caktuar superekspertizën; dhe (ii) Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është në kundërshtim me Kushtetutën sepse *“nuk janë dëgjuar të gjithë dëshmitarët e propozuar nga ai, por janë dëgjuar vetëm dëshmitarët e propozuara nga B.F., dhe për pasojë sipas tij kjo paraqet shkelje procedurale”*.
31. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu konteston Aktvendimin [Ac. nr. 1449/2011] e 30 janarit 2012 të Gjykatës së Qarkut, i nxjerrë në procedurë përkitazi me masën e sigurisë, duke pretenduar që i njëjti është gjithashtu në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës sepse është nxjerrë në kundërshtim *“me dispozitat e procedurës kontestimore dhe atyre përmbarimore”* dhe specifikisht në shkelje të nenit 297 [pa titull] të LPK-së, për arsye se B.F. në cilësinë e paditëses *“nuk ka arritur ta bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës e as të drejtës subjektive”* dhe se *“nuk ka dhënë asnjë garanci në masën dhe llojin e caktuar nga Gjykata për dëmin që mund të shkaktohet palës kundërshtare me caktimin dhe ekzekutimin e masës së sigurimit”*.

32. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata të: (i) deklarojë kërkesën e tij si të pranueshme; (ii) të konstatojë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e kontestuar [Rev. nr. 333/2019] të 6 nëntorit 2019 të Gjykatës Supreme; dhe (iv) çështjen ta kthejë në rivendosje në Gjykatën Supreme.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
 - 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
 - 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
- [...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

- 1. E drejta për një proces të rregullt 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*
- [...]

Ligji Nr. 2004/32 Ligji për Familjen i Kosovës [i publikuar në Gazetën Zyrtare më 1 shtator 2006]

**Neni 46
Pasuria e veçantë e bashkëshortëve**

- (1) Pasuria e cila i ka takuar bashkëshortit në çastin e lidhjes së martesës do të mbetet pasuri e veçantë e tij;
- (2) Pasuria e veçantë është gjithashtu edhe pasuria e fituar gjatë kohëzgjatjes së martesës përmes trashëgimit, dhurimit apo ndonjë forme tjetër ligjore të fitimit të pasurisë;
- (3) Pasuria që i takon bashkëshortit duke u bazuar në proporcionin e pasurisë së përbashkët është gjithashtu pasuri e veçantë;
- (4) Një prodhim arti, punë intelektuale apo pronë intelektuale konsiderohet pasuri e ndarë e bashkëshortit/ës që e ka krijuar;
- (5) Secili bashkëshort në mënyrë të pavarur e administron dhe e posedon pasurinë e vet të veçantë gjatë gjithë kohës së martesës.

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

EKSPERTËT

Neni 356

Gjykata, me propozimin e palëve mundë të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes.

Neni 357

357.1 Pala e cila e propozon ekspertizën ka për detyrë që në propozimin e saj ta tregojë objektin dhe vëllimin e ekspertizës dhe ta propozojë personin që do ta bëjë ekspertizën.

357.2 Palës kundërshtare duhet dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me ekspertizën e propozuar.

357.3 Po që se palët nuk merren vesh për personin që do të bëjë ekspertizën si dhe për objektin dhe vëllimin e tij, vendimin për këtë do ta jep gjykata.

Neni 369

369.1 Kur janë caktuar më tepër se një ekspert, të gjithë ata mund ta paraqesin konstatimin dhe mendimin e përbashkët po që se nuk ka dallime midis tyre. Në qoftë se ekzistojnë dallime në konstatimet dhe mendimet e tyre, atëherë secili nga ta paraqet konstatim dhe mendim të veçantë.

369.2 Në qoftë se të dhënat e ekspertëve në konstatimin e ekspertëve dallohen esencialisht, apo nëse konstatimi i tyre është i paqartë, jo i plotë apo kontradiktor me vete veten apo me rrethanat e shqyrtuara, e këto të meta nuk mund të evitohen me dëgjimin e përsëritur të ekspertëve, do të përsëritet ekspertimi me ekspertë të njëjtë apo me ekspertë të tjerë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Gjykata së pari, shqyrton nëse parashtruesi e kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

35. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë siç janë të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 (Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

36. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës para Gjykatës konteston (i) Aktvendimin [Ac. nr. 1449/2011] e 30 janarit 2012 të Gjykatës së Qarkut, të nxjerrë në procedurë për caktimin e masës së sigurimit; dhe (ii) Aktgjykimin [Rev. nr. 333/2019] e 6 nëntorit 2019 të Gjykatës Supreme.

37. Përkitazi me Aktvendimin [Ac.nr.1449/2011] e 30 janarit 2012 të Gjykatës së Qarkut, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë që kërkesa duhet të parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit. Në rrethanat e rastit konkret, ky nuk është rasti. Në fakt, ky Aktvendim kontestohet në Gjykatë pas më shumë se tetë (8) vitesh.
38. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej katër (4) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Sabri Gunes kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafi 39; shih gjithashtu, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI140/13, me parashtrues *Ramadan Cakiqi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24; dhe KI120/17, me parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 39).
39. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata bazuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, konstaton se kërkesa përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Ac.nr. 1449/2011] të 30 janarit 2012 të Gjykatës së Qarkut, është e papranueshme si e pasafatshme.
40. Ndërsa, përkitazi me Aktgjykimin [Rev.nr.333/2019] e 6 nëntorit 2019 të Gjykatës Supreme, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 333/2019] e 6 nëntorit 2019 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
41. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) në veçanti përcakton që:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

42. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të

papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

43. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. (Shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 30 prillit 2020; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 275 deri më 304).
44. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
45. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me shkurorëzimin e parashtruesit të kërkesës dhe B.F.-së, dhe procedurat pasuese në lidhje me pjesëtimin e pasurisë së përbashkët. B.F. fillimisht kishte iniciuar (i) kërkesën për masën e sigurimit, përmes së cilës, kishte kërkuar ndalimin e tjetërsimit, ngarkimit me barrë, hipotekë, peng ose vërtetim dhe legalizim të çfarëdo kontrate të shitblerjes së paluajtshmërisë kontestuese; dhe (ii) procedurën përkitazi me kërkesën për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët, kërkesë kjo e cila gjatë seancës shqyrtuese para Gjykatës Themelore, ishte zëvendësuar me kërkesë për kompensimin e pasurisë së veçantë bazuar në nenin 46 të Ligjit për Familjen. Procedurat në lidhje me masën e sigurisë, kishin rezultuar në favor të B.F.-së. Ndërsa, në procedurë për kompensim të pasurisë së veçantë, Gjykata Themelore kishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e B.F.-së, duke e detyruar parashtruesin e kërkesës që asaj t’ia kompensojë shumën në vlerë prej 31,582 eurosh. Gjykata Themelore, kishte konstatuar se shtëpia ishte ndërtuar me investimin e babait të B.F.-së, dhe rrjedhimisht kategorizohej si pasuri e veçantë e saj. Vlerën e kompensimit Gjykata Themelore e kishte përcaktuar pasi kishte vlerësuar dy ekspertiza, ndërsa kishte bazuar vendimin e saj në ekspertizën të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte vlerësuar si “më të afërt me realitetin ekzistues”. Përkundër

ankesës dhe kërkesës për revizion, në Gjykatë të Apelit dhe Gjykatë Supreme, respektivisht, të njëjtat kishin konfirmuar konstatimet e Gjykatës Themelore. Para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e Gjykatës Supreme, duke pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, për shkak të mosarsyetimit të vendimit gjyqësor, në lidhje me dy ekspertizat dhe mosaktimit të një superekspertize si rezultat i ekspertizave kundërthënëse sipas parashtruesit të kërkesës.

46. Në vijim, Gjykata fillimisht do t'i shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor, shqyrtim ky në të cilin, Gjykata (i) do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme; dhe me pas, (ii) do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

(i) *Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën në vendim të arsyetuar gjyqësor*

47. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, me parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, me parashtrues "*IKK Classic*", Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, me parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI24/17, me parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019; dhe KI35/18, me parashtrues "*Bayerische Versicherungsverband*", Aktgjykim i 27 janarit 2020.

48. Në parim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; gjithashtu për më shumë detaje në lidhje me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së të 30 prillit 2020, E drejta për një proces të rregullt (aspekti civil), IV. Kërkesat Procedurale, 7. Arsyetimet e Vendimeve Gjyqësore, paragrafët 369 deri 380 dhe referencat e përdorura aty). Një vendim i arsyetuar u tregon palëve se çështja e tyre është dëgjuar me të vërtetë, dhe për pasojë kontribuon në një pranueshmëri më të madhe të vendimeve. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Magnin kundër Francës*, Vendim i 10 majit 2012, paragrafi 29). Kjo praktikë gjyqësore gjithashtu përcakton se përkundër faktit që një gjykatë ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me

përzgjedhjen e argumenteve dhe dëshmime, ajo është e detyruar të justifikojë aktivitetet dhe vendimmarrjen e saj duke dhënë arsyet përkatëse. (Shih rastet e GJEDNJ-së: *Suominen kundër Finlandës*, cituar më lart, paragrafi 36; dhe *Carmel Saliba kundër Maltës*, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73). Për më tepër, vendimet duhet të jenë të arsyetuara në atë mënyrë që t'u mundësojë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Hirvisaari kundër Finlandës*, cituar më lart, paragrafi 30).

49. Thënë këtë, neni 6 i KEDNJ-së i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument. (Shih, rastet e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, cituar më lart, paragrafi 61; *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, Vendim i 29 gushtit 2000; dhe *Perez kundër Francës*, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81). Masa në të cilën zbatohet ky detyrim mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të secilit rast. (Shih, rastet e GJEDNJ-së: *Ruiz Torija kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; dhe *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 27). Për shembull, një gjykatë apeli, mundet, në parim, të refuzojë një ankesë duke miratuar arsyet e vendimit të gjykatës më të ulët, megjithatë edhe një vendim i tillë duhet të përmbajë mjaftueshëm arsyetim për të treguar se gjykata përkatëse nuk ka miratuar konstatimet e arritura nga një gjykatë më e ulët pa konsideratë të mjaftueshme. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Tatishvili kundër Ruisë*, cituar më lart, paragrafi 62).
50. Megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nga gjykatat kërkohet që të shqyrtojnë dhe japin një përgjigje specifike dhe të qartë në lidhje me (i) pretendimet dhe argumentet thelbësore të palës (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 67; dhe *Donadze kundër Gjeorgjisë*, Aktgjykim i 3 marsit 2006, paragrafi 35); (ii) pretendimet dhe argumentet që janë vendimtare për rezultatin e procedurës (shih, rastet e GJEDNJ-së: *Ruiz Torija kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 30; dhe *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 28); dhe (iii) pretendimet në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me KEDNJ dhe Protokollet e saj. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Wagner dhe J.M.W.L. kundër Luksemburgut*, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96 dhe referencat në të).
51. Në fund, Gjykata duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore rikujton se vendimet e gjykatave do të shkelin parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI72/12, parashtrues *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, cituar më lart, paragrafi 61; KI135/14, parashtrues "*IKK Classic*", cituar më lart, paragrafi 58; KI96/16 parashtrues "*IKK Classic*", cituar më lart, paragrafi 52; dhe KI87/18, parashtrues *IF Skadeforsikring*, Aktgjykimin i 26 prillit 2018, paragrafi 49).

(ii) *Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret*

52. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk përmbush standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor sepse nuk ka arsyetuar dështimin e caktimit të një superekspertize, duke marrë parasysh që në rrethanat e rastit konkret, lidhur me vlerën përkatëse të kompensimit kanë ekzistuar dy ekspertizat “*diametralisht të kundërta*”.
53. Përkitazi me ekspertizat bazuar në të cilat gjykatat e rregullta kanë përcaktuar vlerën përkatëse të kompenzimit, Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, Gjykata Themelore ka urdhëruar përgatitjen e dy ekspertizave lidhur me përcaktimin e vlerës së paluajtshme kontestuese. Të parën e kishte urdhëruar përmes Aktvendimit [C.nr.559/2009] të 20 shkurtit 2014, duke i përcaktuar detyrën e përfundimit të ekspertizës ekspertit Q.F., pas propozimit të përfaqësuesit ligjor të B.F.-së që të caktohet eksperti për vlerësimin e “*punëve të kryera dhe materiale të ndërtimitarisë*”. Ndërsa, të dytën e kishte urdhëruar përmes Aktvendimit [C.nr.559/09] të 4 shtatorit 2014, duke i përcaktuar detyrën e përfundimit të ekspertizës ekspertit S.C., pas propozimit të parashtruesit të kërkesës. Ekspertiza e ekspertit Q.F., kishte rezultuar në vlerën e pasurisë në shumën prej 39,708 euro, ndërsa, ekspertiza e ekspertit S.C., kishte rezultuar në vlerën e pasurisë në shumën prej 31,382.72 euro.
54. Në seancën e shqyrtimit kryesor në Gjykatën Themelore, parashtruesi i kërkesës e kishte kontestuar ekspertizën e Q.F.-së, ndërsa përkitazi me ekspertizën e ekspertit S.C., kishte theksuar se të njëjtën e konsideronte si “*më të afërt me realitetin ekzistues*”. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës, gjithashtu kishte theksuar se këto dy ekspertiza janë në kundërshtim me njëra tjetrën, por se për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike të tij nuk e kishte mundësinë e propozimit të një superekspertize. Edhe B.F., në cilësinë e paditëses, nuk ishte pajtuar me vlerën e përcaktuar nga ekspertët përkitazi me paluajtshmërinë kontestuese, duke theksuar se të njëjtat duhet të përmbanin edhe vlerën e orendive e të cilat, sipas saj i kishte blerë i ati i saj, duke theksuar se vlera e kompensimit duhet të përfshinte për pasojë, edhe 12.465 euro shtesë, dhe rrjedhimisht vlerën e përgjithshme prej 44,047 eurove.
55. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata Themelore, kishte dëgjuar edhe një herë të dy ekspertët në seancën e shqyrtimit kryesorë të datës 16 dhjetor 2014 dhe kishte përcaktuar vlerën përkatëse të kompensimit bazuar në ekspertizën e ekspertit S.C., përkatësisht 31,582 euro. Në këtë kontekst, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit të saj, ndër të tjerash, kishte theksuar se “*kësaj ekspertize gjykata në masë të madhe ia fali besimin pasi që në të janë përfshirë në mënyrë më të shkoqitur punët e kryera ndërtimore, me përjashtim të punëve përgatitore të dheut që janë llogaritur me çmim më të ulët se të tregut në rastet e ngjashme. Këtë konstatim gjykata e vërtetoi edhe nga sqarimet e dhëna nga dy (2) ekspertët në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes*”.
56. Gjykata Themelore, gjithashtu kishte refuzuar pretendimet e B.F.-së, sipas të cilave të njëjtës duhet t’i kompenzohet edhe shuma prej 12.465 euro lidhur me orenditë e investuara. Gjykata Themelore, këto pretendime, i refuzoi duke u

bazuar në nenin 323 [pa titull] të LPK-së, bazuar në të cilin, gjykata përkatëse vendos sipas çmuarjes së lirë, në rastet kur vërtetohet, ndër të tjerash se, shpërblimi përkatës i dëmit “do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha”. Për më tepër që, në këtë kontekst, Gjykata Themelore, gjithashtu arsyetoi se “[B.F.] me asnjë provë nuk ka provuar se babai i saj i ka blerë orenditë e shtëpisë si dhuratë për bijën, ashtu si nuk provoi as shumën e kërkuar në emër të borxhit personal, për faktin se gjykata nuk ia ka falur besimin specifikacionit të paditësës si provë materiale”.

57. Parashtruesi i kërkesës i kishte kontestuar konstatimet e Gjykatës Themelore, përmes ankesës në Gjykatën e Apelit dhe përmes kërkesës për revizionin në Gjykatën Supreme, posaçërisht lidhur me mos caktimin e një superekspertize, duke marrë parasysh dallimet në konstatimet e dy ekspertizave.
58. Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.3710/2015] të 11 qershorit 2019, përkitazi me pretendimin e lartcekur të parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, kishte theksuar se Gjykata Themelore kishte vendosur drejtë kur pjesërisht kishte miratuar kërkesëpadinë e B.F.-së në vlerë 31.582,00 euro, bazuar në vlerësimin e ekspertit S.C., “pasi që ekspertizën e mëhershme të bërë nga eksperti [Q.F.], [parashtruesi i kërkesës] e kishte kundërshtuar për shkak të vlerës së lartë të konstatuar nga ai, por që në fund, pas dëgjimit të këtyre ekspertëve nga gjykata, e në prani të palëve, nuk kishte propozuar ekspertizë tjetër eventuale”. Ndërsa, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 333/2019] të 6 nëntorit 2019, në kontekst të këtij pretendimi, kishte konstatuar se pretendimet për shkelje të paragrafit 1 dhe pikës n) të paragrafit 2 të nenit 182 të LPK-së në lidhje me paragrafin 5 të nenit 160 të LPK-së janë të pabazuara, sepse parashtruesi i kërkesës e kishte kundërshtuar ekspertizën e ekspertit Q.F., dhe për pasojë, Gjykata Themelore, më 4 shtator 2014, me kërkesën e parashtruesit të kërkesës e kishte caktuar ekspertin S.C., në të cilën seancë të shqyrtimit, parashtruesi i kërkesës nuk kishte kërkuar ekspertizë tjetër apo superekspertizë.
59. Gjykata gjithashtu thekson se procedura për caktimin e ekspertëve në procedurë kontestimore është përcaktuar me dispozita e LPK-së, përkatësisht me nenet 356 deri 372 të tij. Neni 369 i LPK-së, specifikisht përcakton procedurën që duhet të ndiqet në rastet kur për vlerësimin e një çështjeje janë caktuar më shumë se një ekspert. Bazuar në paragrafin 2 të këtij neni, në qoftë se, ndër të tjera, konstatimet e ekspertëve dallojnë esencialisht, “do të përsëritet ekspertimi me ekspertë të njëjtë apo me ekspertë të tjerë”, në rast se këto dallime nuk mund të evitohen me dëgjimin e përsëritur të ekspertëve.
60. Në rrethanat e rastit konkret, bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se përkundër faktit që para Gjykatës Themelore janë paraqitur dy ekspertiza me vlera të ndryshme (i) Gjykata Themelore ka bazuar përcaktimin e vlerës së kompenzimit bazuar në raportin e ekspertit të cilin e ka propozuar parashtruesi i kërkesës dhe konstatimet e të cilit parashtruesi i kërkesës i kishte cilësuar si “më të afërta me realitetin ekzistues”; dhe (ii) ekspertët ishin dëgjuar sërisht në seancën e shqyrtimit kryesorë të 16 dhjetorit 2014 dhe për pasojë, dallimet në konstatimet e ekspertizave përkatëse ishin adresuar përmes dëgjimit të përsëritur të ekspertëve, siç është përcaktuar në nenin 369 të LPK-së.

61. Gjykata, bazuar në parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën në një vendim të arsyetuar gjyqësor e të shtjelluara më lart, rikujton se në adresimin e pretendimeve të parashtruesve përkatës, gjykatat e rregullta, janë të detyruara që të japin përgjigje, ndër të tjera, lidhur me ato pretendime të cilat janë thelbësore ose përcaktuese për rrethanat e një rastit. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e caktimit të një superekspertize. Këtë pretendim e kishte adresuar posaçërisht Gjykata Supreme, përgjatë vlerësimit të kërkesës së parashtruesit të kërkesës për revizion, duke theksuar, ndër të tjerash, si në vijim:

“Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtojë pretendimet e të paditurit të cekura në revizion, se aktgjykimi i kundërshtuar është marrë në bazë të shkeljes thelbësore nga neni 182 par. 1 e 2 pika (n), lidhur me nenin 160 par. 5 të LPK -es, sic theksohet, se gjykata duhet të kujdeset vet sipas detyrës zyrtare për caktimin e superekspertizës, sepse pala nuk ka pasur mjete për pagesë, se gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsye për pretendimet nga ankesa, dhe nga aktgjykimi nuk mund të kuptohet roli i [E.F]- babait të paditëses, por këto pretendime kjo Gjykate i vlerësojë si të pabazuara, nga fakti se i padituri kishte kundërshtuar ekspertizën e ekspertit [Q.F] pas së cilës gjykata kishte caktuar ekspertin tjetër [S.C] inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë dhe pas dëgjimit të ekspertit në seancën kryesore i padituri nuk kishte propozuar ekspertizë tjetër, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK-ës secila palë ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkesat dhe pretendimet e veta.”

62. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet si më sipër, dhe në mënyrë specifike duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta e të shtjelluara më lart, konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk karakterizohet me mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, dhe se për pasojë, pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor lidhur me mungesën e caktimit të një superekspertize, janë qartazi të pabazuara në *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*.
63. Gjykata, më tej, gjithashtu rikujton që në kontekst të pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës gjithashtu referohet në faktin se *“nuk janë dëgjuar të gjithë dëshmitarët e propozuar nga ai, por janë dëgjuar vetëm dëshmitarët e propozuara nga B.F., dhe për pasojë sipas tij kjo paraqet shkelje procedurale”*.
64. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se në seancën e shqyrtimit kryesor në Gjykatën Themelore, të mbajtur më 20 shkurt 2014, fillimisht ishte dëgjuar dëshmitari i propozuar nga B.F., përkatësisht i ati i saj E.F. Në vijim të shqyrtimit, po ashtu ishte dëgjuar edhe dëshmitarja S.K.H., në cilësinë e arkitektes dhe dëshmitarët e tjerë të cilët kishin kryer punimet në ndërtimin e paluajtshmërisë së kontestuar, respektivisht dëshmitarët E.K., N.H., F.Rr., dhe M.S. Rrjedhimisht,

Gjykata Themelore pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor kishte administruar si prova edhe dëshmitë e dhëna të dëshmitarëve të lartcekur në këtë seancë.

65. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit. Megjithatë, bazuar në shkresat e lëndës, nuk rezulton që pretendimi i lartcekur i parashtruesit të kërkesës përkitazi me dëgjimin e dëshmitarëve të jetë ngritur në ankesën e tij të parashtruar në Gjykatën e Apelit. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës këtë pretendim nuk e kishte ngritur as edhe në kërkesën e tij për revizion të parashtruar në Gjykatën Supreme.
66. Në një kontekst të tillë, kur pretendimet e parashtruesit të kërkesës as formalisht por as në substancë/përmbajtje nuk janë ngritur para gjykatave të rregullta, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJENDJ-së, sa i përket kriterit për shterjen e mjeteve juridike në kuptimin substancial, dhe rikujton se në rrethana të tilla, pretendimet e tilla nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata për mungesë të shterimit të mjeteve juridike në kuptim substancial. Bazuar në po të njëjtën praktikë gjyqësore, Gjykata kishte refuzuar shqyrtimin e pretendimeve përkatëse sepse të njëjtat nuk ishin ngritur asnjëherë para gjykatave të rregullta, ndër të tjera, edhe në rastet e Gjykatës, KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2009 (paragrafi 71), KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2019 (paragrafi 92), KI155/18, parashtrues *Benson Buza*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shtatorit 2019 (paragrafi 50) e KI163/18, parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020 (paragrafi 59).
67. Gjykata rithekson se shterimi i mjeteve juridike ndërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik, kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në "substancë" para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dy kuptimet. (Shih, po ashtu, rastet e Gjykatës, KI71/18, parashtrues, *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafin 57; rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafin 73; rastin KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 94; dhe rastin KI163/18, cituar më lart, paragrafi 61).
68. Një qëndrim i tillë është në përputhshmëri të plotë me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, bazuar në të cilën, për aq sa ekziston një mjet juridik që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë, të paktën në substancë, argumentin për shkelje të një të drejte, atëherë ai mjet juridik duhet të shfrytëzohet. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, pranë gjykatave të rregullta kur ka mundur

të ngrihet gjatë ushtrimit të një mjete juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi të cilën rregulli për shterimin e mjeteve juridike synon ta ofrojë. (Shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës, KI119/17, cituar më lart, paragrafin 72; rastin KI154/17 dhe KIO5/18, cituar më lart, paragrafi 93; rastin KI155/18, cituar më lart, paragrafi 49; dhe rastin KI163/18, cituar më lart, paragrafi 60).

69. Marrë parasysh këto parime dhe në rrethana në të cilat, sipas shkresave të lëndës rezulton se këto pretendime specifike të parashtruesit të kërkesës janë ngritur për herë të parë para Gjykatës, ajo konkludon që parashtruesi i kërkesës nuk i ka dhënë mundësinë Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, që të adresojnë këto pretendime dhe me atë rast, të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesi i kërkesës i ngrit drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, KI118/15, parashtrues *Dragiša Stojković*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-39; rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafi 74; rastin KI154/17 dhe KIO5/18, cituar më lart, paragrafi 95; dhe rastin KI163/18, cituar më lart, paragrafi 62).
70. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se ky pretendim duhet të refuzohet si i papranueshëm në baza procedurale për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
71. Prandaj, dhe përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse, pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me Aktvendimin [Ac.nr.1449/2011] e 30 janarit 2012 të Gjykatës së Qarkut, janë të pasafatshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës; ndërsa pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me Aktgjykimin [Rev. nr. 333/2019] e 6 nëntorit 2019 të Gjykatës Supreme, (i) për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese në "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*", në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës; ndërsa (ii) lidhur me mungesën e dëgjimit të dëshmitarëve përkatës para Gjykatës Themelore, janë të papranueshme si rezultat i mosshterimit të mjeteve juridike në kuptimin substancial, ashtu siç kërkohet me paragrafin 1 dhe 7 te nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20, 47, 48 dhe 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) (c) (d) dhe (2) të Rregullores së punës, më 20 janar 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arita Rama-Hajrizi

Arita Rama-Hajrizi